

URDHËR
Nr. 631, datë 14.11.2022

**PËR AUTORIZIMIN E NËNSHKRIMIT TË KËRKESAVE SOCIAL-JURIDIKE TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE**

Në mbështetje të nenit 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 134, datë 26.11.2003, “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit”, dhe Kodit të Procedurave Administrative,

URDHËROJ

1. Zëvendësimin e znj. Elsa Saka, drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, me z. Lorenc Agalliu, drejtor i Drejtorisë së Arkivave Shtetërore Vendorë, i cili autorizohet të nënshkruaj kërkesat social-juridike të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.
2. Specimeni i firmës së z. Lorenc Agalliu të dërgohet në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
3. Urdhri 314, datë 30.10.2018, “Për autorizimin e nënshkrimit të kërkesave social-juridike të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, shfuqizohet.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido